

TERAPIA ME KOMPONENTE TË GJAKUT TEK RASTET HEMATOLOGJIKE

Leonora Ebibi¹, Bukurije Zhubi²

Abstrakti

Hyrje: Mjekimi modern me transfuzion është terapia me komponente të gjakut i cili nënkupton bartjen e materialit human biologjik në organizmin e marrësit, i cili duhet të jetojë dhe të kryejë funksionin e caktuar biologjik. Andaj mund të thuhet se dhënia e gjakut është një lloj transplantimi i indit që nënkupton ndryshimet imunologjike dhe rrezikun potencial për shëndetin e marrësit. Gjakut mund të përdoret si gjak i plotë apo si përbërës i gjakut si dhe fraksione të plazmës. Qëllimi i transfuzionit është mjekimi i pacientëve me gjak dhe produkte të gjakut të sigurta në situata të ndryshme: si p.sh. trajtimi transfuziv i pacientëve të aksidentuar, ndërhyrjet kirurgjikale, hemorragjitë e mëdha - profuze gjatë lindjes, pacientët me anemi të rëndë akute apo kronike, pacientëve me kemoterapi, e kështu me radhë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të përcaktohet përqindja e dhënjes së dozave të komponenteve të gjakut tek rastet hematologjike në Qendrën Kombëtare të transfuzionit të gjakut të Kosovës.

Metodologjia: Forma e këtij hulumtimi është retrospektiv. Në punim janë përfshirë 203 marrës të terapis me komponente të gjakut të cilët kanë marrë gjak në Qendrën Kombëtare të transfuzionit të gjakut të Kosovës në periudhë kohore prej 1 Prilli 2019 deri më 30 Qershor 2019. Janë analizuar të dhënat për numrin e dozave dhe përqindjen e dhënës të komponenteve të gjakut në përgjithësi.

Rezultatet: Sipas rezultateve, numri i dozave për eritrocitet ishte 225 apo 51.3% numri i dozave për trombocite ishte 131 apo 29.9% si dhe numri i dozave për PFN ishte 82 apo 18.7%. Poashtu është analizuar numri i marrësëve dhe përqindja e dozave të terapis me komponente të gjakut sipas gjinis.Ku numri i marrësëve sipas gjinis ishte 107 meshkuj dhe 96 femra ndërsa përqindja e aplikuar e terapis me komponente të gjakut sipas gjinisë ishte 52.7% meshkuj dhe 47.3% femra. Gjithashtu janë analizuar të dhënat për aplikimin e terapis me komponente të gjakut sipas grupmoshave ku mosha më dominante ishte 36-60 vjeq ku përqindja e dhënës së terapisë me komponente të gjakut ishte 48.70%.

Rekomandimet: Rekomandohet që të shmangen transfuzionet me gjak alogjenik, të planifikohet përdorimi i gjakut autolog, të shmangen reaksionet postransuzive, të shmangët transmetimi i infeksioneve, të shmangët mbingarkesa në qarkullim, të shmangen gabimet procedurale.

Fjalët kyqe: Transfuzioni, terapia me komponente të gjakut, trajtimi transfuziv i pacientëve, Kosovë.